

PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS



KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE

Shërbimet Sociale në Komuna

Trendet e financimit 2010–2023

Janar, 2023



Norwegian Embassy

DEM

Aktiviteti u realizua në kuadrin e programit 'Dialogu për Komunitat Evropiane' (DEM), i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

Përmbajtja:

Përshkrimi i Përgjithshëm	3
Nismat Ligjore për Financimin e Shërbimeve Sociale	3
Sfidat kyçe në ofrimin e shërbimeve sociale	4
Financimi i Shërbimeve Sociale	5
Financimi i Kapaciteteve Menaxhuese dhe Profesionale	6
Financimi i Mallrave dhe Shërbimeve.....	7
Financimi i Shpenzimeve të Komunalive.....	7
Financimi i Subvencioneve dhe Transfereve	8
Financimi i Shpenzimeve Kapitale	8
Tabela e Komunave sipas viteve në investime kapitale	8
Tabela e renditjes së komunave sipas përqindjes (%) së financimit 2010, 2013 dhe 2023;	10
Konkluzione	13
Rekomandime	14

Përshkrimi i Përgjithshëm

Raporti për Vendin i Komisionit Evropian i vitit 2022, thekson se 'Kosova ka nxjerr ligje për decentralizimin e një sërë kompetencave në fushën e shërbimeve sociale, mirëpo Qeveria e Kosovës ende nuk e ka miratuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, ku parashihet ndarja e Grantit të Veçantë për shërbimet sociale, ngjashëm me Grantin Specifik për arsim dhe shëndetësi'.

Prej 1999-2009, shërbimet sociale kanë qenë të centralizuara, ndërkaq prej vitit 2009, nëpërmjet një Memorandumi të Mirëkuptimit, (MM) të nënshkruar mes tri Ministrive (Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal), shërbimet sociale janë të decentralizuara, ku komunat individuale janë plotësisht përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale¹, edhe pse një pjesë e shërbimeve dhe pagesave ka mbetur në nivelin qendror. Nga viti 2009 deri tani, Granti i Përgjithshëm ka pasur rritje, nuk është vërejtur gatishmëri më e madhe e komunave në financim të qëndrueshëm, madje në disa prej tyre ka pasur rënie të financimit të shërbimeve sociale.

Në vitin 2010, Granti Specifik është reduktuar në 50%; ku 50% është përfshirë në Grantin e Përgjithshëm dhe 50 % ka qëndruar si grant specifik për shërbime sociale. Nga viti 2013 e deri tani, i tërë Granti Specifik është shkruar në Grantin e Përgjithshëm. Shuma që është transferuar nga niveli qendror është përfshirë në Grantin e Përgjithshëm, e pastaj është shpërndarë si përgjegjësi vetanake. Nga viti 2005 deri në fund të vitit 2015, shtëpitë e pleqve dhe të personave me aftësi të kufizuara kanë qenë kompetencë e nivelit qendror, në vitin 2016, përgjegjësitë për menaxhim janë transferuar në Komuna, por me financim nga niveli qendror.

Nismat Ligjore për Financimin e Shërbimeve Sociale

Me vendimin e Qeverisë, **07/75**, të datës 13.11.2018, është aprovuar koncept-dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal, ndërkaq me vendimin **08/2019**, është themeluar grupi punues për hartimin e Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal, i cili ka dalë në konsultim publik në datat: **(16.07.2019 - 06.08.2019)**. Po ashtu, edhe në Programin Legjislativ për vitin 2022 ishte përcaktuar **afati 15.09.2022**², për aprovim.

Ndryshimet kryesore të parapara në Projektligj ishin: përfshirja e Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale; përfshirja e grantit të veçantë për projekte kapitale; forcimi i përfaqësimit të zërit të komunave në Komisionin e Financimit Komunal; transferi i buxhetit nga niveli lokal në qendror lidhur me shërbimet e centralizuara; një mjedis më përkrahës për zhvillim ekonomik lokal; kritere më të qarta për përcaktimin e granteve të veçanta; rregulla dhe procedura të qarta për planifikim të të hyrave vetanake.

Në marsin e 2021, në programin qeverisës (2021-2025)³, në pikën 2.1.2, mbrojtja sociale, thuhet 'ndër të tjera, do të rishikojmë kornizën ligjore për skemat sociale dhe pensionale, ku hyjnë shërbimet sociale dhe familjare, skemat pensionale të financuara nga shteti, ndihmat sociale, vlerësimi, njohja e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara. Do ta rishikojmë kornizën ligjore për financim publik të OJQ-ve dhe grantin për shërbime sociale dhe familjare'.

Në këtë rrjedhë, për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve sociale, asokohe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka draftuar **Projektligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare**, i cili ka kaluar

¹ <https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/PolicyBrief-ALB.pdf>

² <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Programi-Legjislativ-per-Vitin-2022-.pdf>

³ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

procesin e konsultimit publik mes datave (26.02.2021 -18.03.2021)⁴. Projektligj ky, që është paraparë edhe në Programin Legjislativ 2022, në afatin 22.11.2022⁵.

Sfidat kyçe në ofrimin e shërbimeve sociale

Edhe pesëmbëdhjetë (15) vite pas decentralizimit, ende vërehen mangësi të theksuara, në veçanti në ofrimin e shërbimeve sociale në komuna. Procesi i decentralizimit, kërkon përpjekje të vazhdueshme të ndihmës, teknike, profesionale, operacionale dhe financiare, si në nivel komunal, ashtu edhe nga pushteti qendror. Në mënyrë që të bëhet funksional, në rend të parë komunat duhet të rrisin edhe më tutje kapacitetet menaxhuese si dhe të ketë bashkërendim me nivelin qendror, përkatësisht ministrinë e linjës.

Komunave u është dhënë mandat i qartë që të marrin përgjegjësinë për ofrimin e ndihmës sociale dhe shërbimeve sociale (me përjashtim të pagesës së pensioneve). Ka pak qartësi – si në nivelin komunal, ashtu edhe në atë qendror – për atë se si të zbatohet ky mandat. Gjetja e mekanizmave për ofrimin e këtyre shërbimeve ndërmjet komunave dhe ministrisë së linjës, ende vazhdon të mbetet sfiduese. Ekziston një nevojë e madhe për një komunikim të strukturuar në disa nivele, si atë komunal, nivelin qendror, por edhe organizatat e specializuara në ofrimin e shërbimeve sociale. Parë nga niveli i financimit, krahasuar në tri (3) vite (2010, 2013, 2023) komunat ende operojnë me nivele të ulëta të përkrahjes për kompetencat në ushtrimin e shërbimeve të decentralizuara.

Sipas Raportit Vjetor 2019 të Avokatit të Popullit, për shkak të mungesës së stafit profesional, mbikëqyrjes, planifikimit të financimit dhe të avancimit të shërbimeve në përputhje me nevojat e komunave, QPS-të janë shndërruar në njësi administrativo-teknike.⁶ Qendrat për punë sociale ofrojnë 30-50 shërbime në nivel komunal. Këto shërbime përfshijnë mbrojtjen e fëmijëve, të moshuarve, të grupeve të cenuara, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të trafikimit, viktimave të dhunës e një varg i madh i shërbimeve. Disa të dhëna: personat me aftësi të kufizuara përbëjnë rreth 4.5% e popullsisë, ku 50% nga ta kanë nevojë për shërbime sociale. Personat mbi 65 vjeç përbëjnë rreth 6% të popullsisë, ku rreth 1% nga ta kanë nevojë për shërbime rezidenciale në familje të ndryshme sociale. Fëmijët përbëjnë rreth 30% të popullsisë, ku 1.5% nga ta kanë nevojë për marrjen e shërbimeve sociale.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me mbështetjen e projektit të KE-së ka përafruar procesin e kostimit të çmimeve të ofrimit të disa lloje të shërbimeve. Në aspektin e qëndrueshmërisë dhe sigurimit të kualitetit të shërbimeve, vërehet që nuk ka pasur shërbime adekuate të mbështetjes me financim për këto shërbime nga nivelet komunale. Përderisa, nga niveli qendror, në bazë të kriterëve dhe koston financohet operimi për shtëpitë në mes viteve 2016 - 2018 nuk është paraqitur ndonjë problem në financimin e shërbimeve rezidenciale.


Parë këto të dhëna, është e domosdoshme të ofrohen alternativa dhe propozimet lidhur me hapat e ardhshëm për rritjen e alokimeve buxhetore për shërbime sociale nga Granti i Përgjithshëm, meqenëse aktualisht nuk ka grant specifik për shërbime sociale.

⁴ <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41073>

⁵ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Programi-Legislativ-per-Vitin-2022-.pdf>

⁶ <https://oik-rks.org/2020/04/02/raporti-vjetor-2019/>

Financimi i Shërbimeve Sociale	€ 1,984,878	€ 3,309,911.00	€ 5,676,106.00
Granti i Përgjithshëm i Komunave	€ 94,270,000.00	€ 134,491,791.60	€ 255,210,000.00
Viti	2010	2013	2023
Përqindja (%)	2.11%	2.5%	2.22%



Financimi i Shërbimeve Sociale

Në krahasim kemi vendos tri vite (2010), kur është bartur financimi nga qendra tek komuna nëpërmes Grantit të Përgjithshëm, viti (2013), kur është përmbyllur procesi i decentralizimit, si dhe viti aktual (2023).

Viti	Financimi	Shpenzimet për Shërbime Sociale	Buxheti	Përqindja
2010	Granti i Përgjithshëm	€ 1,984,878.00	€ 94,270,000.00	2.11%
	Të hyrat vetanake	€ 168,654.00	€ 50,400,000.00	0.33%
2013	Granti i Përgjithshëm	€ 3,309,911.00	€ 134,491,791.60	2.46%
	Të hyrat vetanake	€ 437,734.00	€ 63,394,000.00	0.69%
2023	Granti i Përgjithshëm	€ 5,676,106.00	€ 255,210,000.00	2.22%
	Të hyrat vetanake	€ 1,520,376.00	€ 98,519,262.00	1.54%

Në vitin 2009 financimi i bartur nga MPMS në komuna për shërbime sociale ka qenë **2.9 milionë** euro, që nënkupton financimin e të gjitha QPS-ve në nivel vendi, trendët e financimit të shërbimeve sociale, parë në përqindje, kanë stagnuar sa i përket financimit nga Granti i Përgjithshëm, në vitin 2010 ky financim ishte 2.11%, në vitin 2013, 2.46 % dhe 2023, 2.22%. Përderisa, nga të hyrat vetanake, ka pasur rritje të vogël, edhe kjo kryesisht vërehet në disa komuna, në veçanti komunat ato të mëdha që kanë kapacitete më të larta në mbledhjen e të hyrave vetanake.

Në tabelën e financimit të komunave për shërbime sociale, nëpërmjet Grantit të Përgjithshëm, del se në **mes viteve 2010 – 2013**, nga 33 komunat që kanë planifikuar financim, në 16 prej tyre ka pasur ulje të nivelit të financimit; në dy komuna financimi në përqindje ka reflektuar i njëjtë, ndërkaq 5 komuna nuk kanë planifikuar financim (Kllokot, Laposaviç, Zveçan dhe Zubin Potok, Partesh). Ndërkaq, në **krahasimin 2013 - 2023**, nga 36 komuna që kanë planifikuar financim të shërbimeve sociale nga granti i përgjithshëm, në 28 komuna, ka pasur rënie të përqindjes së financimit; në 3 komuna që në 2013, ishim me 0, ka pasur financim; në 1 komunë nivel të njëjtë të financimit; në 3 komuna rritje; ndërkaq 2 komuna nuk ka pasur planifikim (Partesh dhe Kllokot).

Në tabelën e financimit të komunave për shërbime sociale, nëpërmjet të hyrave vetanake, mes viteve 2010 - 2013, se në vitin 2010 kishin planifikuar financim vetëm 3 komuna, ndërkaq në vitin 2013, ishin 18 komuna që planifikuan financim, me total 0.66% e totalit të të hyrave vetanake; në 2023, ka rënë në 13 numri i komunave që kanë planifikuar financim; ku në 6 komuna ka rënie krahasuar me ato të vitit 2013; në 4 komuna ka ngritje të financimit; në 2 komuna reflekton financimi i vitit 2023, për dallim nga 2010 dhe 2013 që nuk kishin planifikuar financim.

Në raportin e Koalicionit i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMPF), financimi i shërbimeve sociale, theksohet 'niveli aktual i financimit komunal nuk plotëson as për së afërmi nevojat të cilat këto shërbime kërkojnë për të qenë në nivelin optimal të funksionimit. Megjithatë, një numër i komunave ka ndarë kohë pas kohe shuma të caktuara parash për të mbajtur gjallë këto shërbime në momente të caktuara kur këto shërbime kanë rrezikuar të mbyllen⁷.

Financimi i Kapaciteteve Menaxhuese dhe Profesionale

Nga të dhënat në tri (3) vitet e analizuar, në vitin 2010, kur financimi është bartur tek komunat, vitit 2013, kur është përmbyllur procesi i decentralizimit (themelimit të komunave të reja) dhe viti aktual 2023, del se në:

Viti	Numri i të Punësuarve	Financimi	Përqindja nga Granti i Përgjithshëm	Numri i Komunave	Komunat pa Staf të Shërbimeve Sociale
2010	255	€ 1,226,665	61.80%	30	Kllokot, Laposaviç, Shtërpcë, Zveçan, Ranillug dhe Zubin Potok; komuna e (Parteshit) financimin e kishte në kuadrin e komunës amë, Gjilanit, ndërkaq (Mitrovica e Veriut), ende e pa themeluar;
2013	422	€ 1,759,174	53.15%	33	Kllokot, Laposaviç, Zveçan dhe Zubin Potok, Partesh); Mitrovica e Veriut ishte (Zyra Koordinuese e Mitrovicës Veriut);
2023	466	€ 2,086,004	39.86%	36	Partesh dhe Kllokot

Përkundër rritjes së nevojave, ende ka mangësi të mëdha në plotësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale. Si rezultat i mungesës së të dhënave të konsoliduara të

⁷ <https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/financimi-i-sherbimeve-sociale.pdf>

numrit të kategorive që kërkojnë shërbime sociale, është problematike vendosja e standardeve edhe për numrin e stafit, në veçanti atij profesional. Po ashtu, përfshirja e stafit menaxhues dhe administrativ, ulë potencialin e kapaciteteve profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale.

Financimi i Mallrave dhe Shërbimeve

Në tri vite është krahasuar financimi i kategorisë ekonomike Mallra dhe Shërbime nga Granti i Përgjithshëm, përfshirë edhe financimet nga Të hyrat vetanake në tri vite (2010, 2013, 2023). Nga Buxheti total i financimit të Shërbimeve Sociale, për kategorinë Paga dhe Mëditje sipas viteve, përjashtuar investimet kapitale:

Viti	Financimi	Mallra dhe Shërbime	Financimi i Shërbimeve Sociale përjashtuar Investimet kapitale	Përqindja
2010	Granti i Specifik dhe GP	€ 522,637.00	€ 1,903,582.00	27.05%
	Të hyrat vetanake	-	€ 105,000.00	0%
2013	Granti i Përgjithshëm	€ 426,457.00	€ 2,760,411.00	15.4%
	Të hyrat vetanake	€ 101,384.00	€ 417,734.00	24.27%
2023	Granti i Përgjithshëm	€ 1,294,848.00	€ 4,913,738.00	26.35%
	Të hyrat vetanake	€ 280,262.00	€ 851,376.00	32.92%

Krahasuar në vlerë të financimit, mes viteve 2010 dhe 2013, del se diferenca ishte vetëm 5,204 euro më shumë, ndërkaq mes vitit 2013 dhe 2023, del se përqindja e financimit nga granti i përgjithshëm është rritur për 10.95% afërsisht e njëjta ka ndodhur edhe nga të hyrat vetanake, me 8.65%.

Financimi i Shpenzimeve të Komunalive

Në krahasimin mes viteve, 2010, 2013 dhe 2023, del se financimi i shpenzimeve të komunalive, nga Granti i Përgjithshëm ka pësuar rënie në përqindje (%), krahasuar mes vitit 2010, kur ishte 7.54%, në 2013, 4.74% dhe 2023, që është planifikuar 2.83% e financimit të shërbimeve sociale, përjashtuar nga llogaritja investimet kapitale. Për dallim, ku nga të hyrat vetanake, në vitin 2010, financimi i kësaj kategorie ishte 0%, në 2013, 0.32%, ndërkaq në 2023, ka pasur rënie në 0.12%.

Viti	Financimi	Komunalitë	Financimi i Shërbimeve Sociale përjashtuar Investimet kapitale	Përqindja
2010	Granti i Specifik dhe GP	€ 143,593.00	€ 1,903,582.00	7.54%
	Të hyrat vetanake	-	€ 105,000.00	0%
2013	Granti i Përgjithshëm	€ 130,726.00	€ 2,760,411.00	4.74%
	Të hyrat vetanake	€ 1,350.00	€ 417,734.00	0.32%
2023	Granti i Përgjithshëm	€ 139,200.00	€ 4,913,738.00	2.83%
	Të hyrat vetanake	€ 1,000.00	€ 851,376.00	0.12%

Financimi i Subvencioneve dhe Transfereve

Financimi i kategorisë subvencione dhe transfere mes viteve 2010, 2013 dhe 2023 na paraqet këto të dhëna:

Viti	Financimi	Subvencione dhe Transfere	Financimi i Shërbimeve Sociale përjashtuar Investimet kapitale	Përqindja
2010	Granti i Specifik dhe GP	€ 10,687.00	€ 1,903,582.00	0.56%
	Të hyrat vetanake	€ 105,000.00	€ 105,000.00	100%
2013	Granti i Përgjithshëm	€ 5,500.00	€ 2,760,411.00	0.20%
	Të hyrat vetanake	€ 315,000.00	€ 417,734.00	75.41%
2023	Granti i Përgjithshëm	€ 611,686.00	€ 4,913,738.00	12.45%
	Të hyrat vetanake	€ 570,114.00	€ 851,376.00	66.96%

Në krahasimin mes viteve 2010 dhe 2013, del se financimi i subvencioneve dhe transfereve nga Granti i Përgjithshëm ka pasur rritje. Por, për dallim nga viti 2010, që nga të hyrat vetanake, ishte 100% e financimit vetëm në këtë kategori, në 2013, kjo kishte 75% e financimit të shërbimeve sociale, përjashtuar investimet kapitale. Ndërkaq, në vitin 2023, ka pasur rritje të mbi 12.25%, ndërkaq nga të hyrat vetanake një rënie prej 8.46%.

Financimi i Shpenzimeve Kapitale

Shpenzimet kapitale mes viteve 2010, 2013 dhe 2023 reflektojnë në këto të dhëna:

Viti	Financimi	Shpenzime Kapitale	Financimi i Shërbimeve Sociale	Përqindja
2010	Granti i Specifik dhe GP	€ 81,296.00	€ 1,984,878.00	4.10%
	Të hyrat vetanake	€ 63,654.00	€ 168,654.00	37.7%
2013	Granti i Përgjithshëm	€ 549,500.00	€ 3,309,911.00	16.6%
	Të hyrat vetanake	€ 20,000.00	€ 437,734.00	4.6%
2023	Granti i Përgjithshëm	€ 712,368.00	€ 5,676,106.00	12.6%
	Të hyrat vetanake	€ 669,000.00	€ 1,520,376.00	44%

Nëse i krahasojmë të dhënat mes vitit 2010 dhe 2013, del se investimet kapitale në totalin e financimit të shërbimeve sociale, nga Granti i Përgjithshëm janë rritur për 12.5%, ndërkaq nga të hyrat vetanake kanë rënë më 30.1%. Në mes vitit 2013 dhe 2023, financimi nga Granti i Përgjithshëm ka pësuar rënë për 4%, ndërkaq financimi nga të hyrat vetanake ka shënuar ngritje, për 39.4%.

Tabela e Komunave sipas viteve në investime kapitale

Të Hyrat Vetanake Komunale					Granti i Përgjithshëm i Komunave						
2010		2013		2023		2010		2013		2023	
Kaçanik	100.00%	Gjakovë	50.00%	Leposaviq	97.35%	Kaçanik	25.04%	Prizren	70.31%	Kaçanik	74.63%
Malishevë	100.00%			Mamushë	70.66%	Shtime	20.33%	Kaçanik	12.11%	Gjakovë	70.62%
				Graçanicë	4.58%	Viti	18.21%	Glllogovc	5.01%	Istog	17.54%
						Fushë Kosovë	16.29%	Mitrovicë e Jugut	2.84%	Vushtrri	6.89%
						Gjakovë	12.05%			Prishtinë	4.52%
						Suharekë	7.73%			Prizren	4.24%
						Mitrovicë e Jugut	7.03%				
						Istog	6.80%				
						Lipjan	6.73%				
						Kamenicë	5.48%				
						Prizren	1.91%				

Financimi i Shërbimeve Sociale




Tabela e renditjes së komunave sipas përqindjes (%) së financimit 2010, 2013 dhe 2023;

Rënditja e komunave sipas financimit në % të shërbimeve sociale nga të hyrat vetanake, përjashtuar investimet kapitale mes viteve (2010, 2013, 2023)			Rënditja e komunave sipas financimit në % të shërbimeve sociale nga Granti i Përgjithshëm, përjashtuar investimet kapitale mes viteve (2010, 2013, 2023)		
1	Mitrovicë e Jugut	10.2%	1	Shtime	10.8%
2	Viti	6.5%	2	Obiliq	10.2%
3	Pejë	4.5%	3	Skenderaj	8.5%
4	Prizren	4.3%	4	Mitrovicë e Jugut	8.3%
5	Shterpce	3.0%	5	Fushë Kosovë	8.3%
6	Skenderaj	2.3%	6	Kamenicë	8.1%
7	Kaçanik	1.8%	7	Novoberd	7.8%
8	Novoberd	1.6%	8	Shterpce	7.5%
9	Prishtinë	1.4%	9	Gllgovc	7.5%
10	Graçanicë	1.3%	10	Malishevë	7.2%
11	Klinë	1.3%	11	Prishtinë	7.0%
12	Gjakovë	0.8%	12	Prizren	6.8%
13	Istog	0.8%	13	Klinë	6.7%
14	Rahovec	0.5%	14	Viti	6.7%
15	Shtime	0.5%	15	Hani i Elezit	6.6%
16	Hani i Elezit	0.3%	16	Kaçanik	6.4%
17	Gjilan	0.3%	17	Rahovec	6.3%
18	Malishevë	0.3%	18	Deçan	6.2%
19	Kamenicë	0.2%	19	Istog	6.2%
20	Suharekë	0.2%	20	Junik	6.0%
21	Vushtrri	0.2%	21	Dragash	6.0%
22	Ferizaj	0.1%	22	Ranillug	5.8%
23	Deçan	0.0%	23	Mamushë	5.7%
24	Gllgovc	0.0%	24	Mitrovica e Veriut	5.5%
25	Dragash	0.0%	25	Pejë	5.5%
26	Fushë Kosovë	0.0%	26	Lipjan	5.4%
27	Leposaviq	0.0%	27	Gjakovë	5.0%
28	Lipjan	0.0%	28	Vushtrri	4.5%
29	Obiliq	0.0%	29	Suharekë	4.4%
30	Podujevë	0.0%	30	Graçanicë	4.3%
31	Zubin Potok	0.0%	31	Zubin Potok	4.2%
32	Zvecan	0.0%	32	Ferizaj	4.1%
33	Junik	0.0%	33	Gjilan	3.9%
34	Mamushë	0.0%	34	Zvecan	3.8%
35	Ranillug	0.0%	35	Podujevë	3.5%
36	Partes	0.0%	36	Leposaviq	1.7%
37	Klllokot	0.0%	37	Partes	0.0%
38	Mitrovicë Veriore	0.0%	38	Klllokot	0.0%

Financimi i Shërbimeve Sociale nga Granti i Përgjithshëm, përjashtuar Investimet Kapitale										
Nr	Komuna	Viti 2010			Viti 2013			Viti 2023		
		Shërbimet Sociale	Granti Specifik/GP	%	Shërbimet Sociale	Granti i Përgjithshëm	%	Shërbimet Sociale	Granti i Përgjithshëm	%
1	Deçan	€ 53,048.00	€ 1,715,400.00	↑ 3.1%	€ 53,807.00	€ 2,620,791.00	↓ 2.1%	€ 90,600.00	€ 5,583,592.00	↓ 1.6%
2	Gjakovë	€ 73,016.00	€ 4,616,140.00	→ 1.6%	€ 138,000.00	€ 6,431,621.00	↑ 2.1%	€ 166,400.00	€ 13,219,264.00	↓ 1.3%
3	Gilgovec	€ 67,257.00	€ 2,386,903.00	↑ 2.8%	€ 94,750.00	€ 3,313,996.00	↑ 2.9%	€ 143,841.00	€ 7,829,315.00	↓ 1.8%
4	Gjilan	€ 83,576.00	€ 4,368,558.00	↑ 1.9%	€ 95,456.00	€ 7,043,959.00	↓ 1.4%	€ 141,100.00	€ 12,094,194.00	↓ 1.2%
5	Dragash	€ 51,993.00	€ 1,887,639.00	↑ 2.8%	€ 54,700.00	€ 2,555,540.00	→ 2.1%	€ 67,000.00	€ 5,925,948.00	↓ 1.1%
6	Istog	€ 57,452.00	€ 1,975,455.00	↑ 2.9%	€ 62,000.00	€ 3,735,604.00	↓ 1.7%	€ 94,000.00	€ 5,887,266.00	↓ 1.6%
7	Kaçanik	€ 33,973.00	€ 1,405,507.00	↑ 2.4%	€ 47,186.00	€ 1,892,018.00	↑ 2.5%	€ 67,972.00	€ 4,603,825.00	↓ 1.5%
8	Klinë	€ 52,536.00	€ 1,884,609.00	↑ 2.8%	€ 59,189.00	€ 2,804,746.00	↓ 2.1%	€ 99,700.00	€ 5,458,575.00	↓ 1.8%
9	Fushë Kosovë	€ 43,980.00	€ 1,452,539.00	↑ 3.0%	€ 62,266.00	€ 1,956,925.60	↑ 3.2%	€ 102,373.00	€ 4,916,458.00	↓ 2.1%
10	Kamenicë	€ 86,214.00	€ 2,203,915.00	↑ 3.9%	€ 81,000.00	€ 3,145,777.00	→ 2.6%	€ 85,528.00	€ 5,360,529.00	↓ 1.6%
11	Mitrovicë e Jugut	€ 132,296.00	€ 4,639,791.00	↓ 2.9%	€ 171,060.00	€ 5,083,590.00	↑ 3.4%	€ 202,500.00	€ 9,725,479.00	↓ 2.1%
12	Leposaviq	€ -	€ 1,354,425.00	↓ 0.0%	€ -	€ 1,816,552.00	↓ 0.0%	€ 64,352.00	€ 3,744,962.00	↑ 1.7%
13	Lipjan	€ 58,857.00	€ 2,854,044.00	↑ 2.1%	€ 76,042.00	€ 3,916,157.00	↑ 1.9%	€ 110,264.00	€ 8,013,741.00	↓ 1.4%
14	Novobërdë	€ 28,193.00	€ 793,174.00	↑ 3.6%	€ 24,188.00	€ 1,041,606.00	↓ 2.3%	€ 29,000.00	€ 1,486,259.00	↓ 2.0%
15	Obiliq	€ 55,317.00	€ 1,184,896.00	↑ 4.7%	€ 44,356.00	€ 1,586,128.00	↓ 2.8%	€ 86,000.00	€ 3,090,306.00	↓ 2.8%
16	Rahovec	€ 69,777.00	€ 2,538,998.00	↑ 2.7%	€ 78,520.00	€ 3,811,433.00	→ 2.1%	€ 115,284.00	€ 7,605,075.00	↓ 1.5%
17	Pejë	€ 80,527.00	€ 4,779,290.00	↓ 1.7%	€ 188,500.00	€ 7,244,129.00	↑ 2.6%	€ 170,134.00	€ 13,593,497.00	↓ 1.3%
18	Podujevë	€ 64,475.00	€ 4,586,070.00	↑ 1.4%	€ 87,186.00	€ 6,295,712.00	↑ 1.4%	€ 81,229.00	€ 12,119,451.00	↓ 0.7%
19	Prishtinë	€ 184,708.00	€ 14,418,444.00	↓ 1.3%	€ 360,000.00	€ 19,820,593.00	↓ 1.8%	€ 1,014,736.00	€ 26,020,156.00	↑ 3.9%
20	Prizren	€ 174,690.00	€ 8,775,027.00	↓ 2.0%	€ 225,100.00	€ 12,322,760.00	↓ 1.8%	€ 749,635.00	€ 25,412,893.00	↑ 2.9%
21	Skenderaj	€ 79,144.00	€ 2,313,899.00	↑ 3.4%	€ 111,300.00	€ 3,360,627.00	↑ 3.3%	€ 122,000.00	€ 7,012,017.00	↓ 1.7%
22	Shtime	€ 39,199.00	€ 1,204,247.00	↓ 3.3%	€ 64,871.00	€ 1,613,478.00	↑ 4.0%	€ 134,300.00	€ 3,795,364.00	→ 3.5%
23	Shtërpcë	€ -	€ 884,507.00	↓ 0.0%	€ 47,446.00	€ 1,417,573.00	↑ 3.3%	€ 65,579.00	€ 1,573,241.00	↑ 4.2%
24	Suharekë	€ 56,942.00	€ 3,143,378.00	↑ 1.8%	€ 71,000.00	€ 4,598,626.00	→ 1.5%	€ 88,000.00	€ 8,132,699.00	↓ 1.1%
25	Ferizaj	€ 77,724.00	€ 4,292,628.00	↑ 1.8%	€ 77,083.00	€ 5,890,079.00	→ 1.3%	€ 136,222.00	€ 14,463,884.00	↓ 0.9%
26	Viti	€ 43,878.00	€ 1,914,789.00	→ 2.3%	€ 77,179.00	€ 2,597,155.00	↑ 3.0%	€ 91,136.00	€ 6,395,380.00	↓ 1.4%
27	Vushtrri	€ 58,654.00	€ 3,009,756.00	↑ 1.9%	€ 74,343.00	€ 4,113,066.00	↑ 1.8%	€ 121,587.00	€ 9,403,786.00	↓ 1.3%
28	Zubin Potok	€ -	€ 1,061,755.00	↓ 0.0%	€ -	€ 1,412,729.00	↓ 0.0%	€ 85,000.00	€ 2,033,093.00	↑ 4.2%
29	Zveçan	€ -	€ 1,001,115.00	↓ 0.0%	€ -	€ 1,339,743.00	↓ 0.0%	€ 70,500.00	€ 1,877,813.00	↑ 3.8%
30	Malishevë	€ 49,200.00	€ 2,121,390.00	→ 2.3%	€ 98,915.00	€ 2,983,239.00	↑ 3.3%	€ 115,028.00	€ 7,382,578.00	↓ 1.6%
31	Junik	€ 13,697.00	€ 514,433.00	↑ 2.7%	€ 12,222.00	€ 658,319.00	↓ 1.9%	€ 15,226.00	€ 1,002,123.00	↓ 1.5%
32	Mamushë	€ 13,696.00	€ 450,592.00	↑ 3.0%	€ 9,975.00	€ 569,211.00	→ 1.8%	€ 12,851.00	€ 1,344,871.00	↓ 1.0%
33	Hani i Elezit	€ 13,697.00	€ 532,995.00	↑ 2.6%	€ 17,331.00	€ 733,984.00	↑ 2.4%	€ 23,528.00	€ 1,431,545.00	↓ 1.6%
34	Graçanicë	€ 5,866.00	€ 1,183,221.00	↓ 0.5%	€ 36,914.00	€ 1,581,068.00	↑ 2.3%	€ 41,633.00	€ 2,758,902.00	→ 1.5%
35	Ranillug	€ -	€ 417,797.00	↓ 0.0%	€ 17,332.00	€ 523,735.00	↑ 3.3%	€ 26,000.00	€ 1,043,474.00	↑ 2.5%
36	Partesh	€ -		0.0%	€ -	€ 514,006.00	0.0%	€ -	€ 548,416.00	0.0%
37	Klllokot	€ -	€ 402,674.00	0.0%	€ -	€ 502,791.00	0.0%	€ -	€ 574,406.00	0.0%
38	Mitrovica e Veriut	€ -		↓ 0.0%	€ 41,194.00	€ 1,642,725.00	↑ 2.5%	€ 83,500.00	€ 2,745,623.00	↑ 3.0%
Totali		€ 1,903,582.00	€ 94,270,000.00	↑ 2.02%	€ 2,760,411.00	€ 134,491,791.60	↑ 2.05%	€ 4,913,738.00	€ 255,210,000.00	↓ 1.93%

Financimi i Shërbimeve Sociale nga Të Hyrat Vetake, përjashtuar Investimet Kapitale										
Nr	Komuna	2010			2013			2023		
		Shërbimet Sociale	Të hyrat vetanake	Përqindja	Shërbimet Sociale	Të hyrat vetanake	Përqindja	Shërbimet Sociale	Të hyrat vetanake	Përqindja
1	Deçan	€ -	€ 500,641.00	0.00%	€ -	€ 600,000.00	0.00%	€ -	€ 1,098,485.00	0.00%
2	Gjakovë	€ -	€ 2,563,606.00	↓ 0.00%	€ 20,000.00	€ 2,900,000.00	↑ 0.69%	€ 5,000.00	€ 4,203,787.00	↓ 0.12%
3	Glllogoc	€ -	€ 627,741.00	0.00%	€ -	€ 1,000,000.00	0.00%	€ -	€ 1,357,468.00	0.00%
4	Gjilan	€ -	€ 3,000,000.00	↓ 0.00%	€ 4,770.00	€ 3,600,000.00	↑ 0.13%	€ 9,000.00	€ 4,952,586.00	↑ 0.18%
5	Dragash	€ -	€ 356,891.00	0.00%	€ -	€ 420,000.00	0.00%	€ -	€ 500,037.00	0.00%
6	Istog	€ -	€ 740,670.00	↓ 0.00%	€ -	€ 900,000.00	↓ 0.00%	€ 10,000.00	€ 1,244,588.00	↑ 0.80%
7	Kaçanik	€ -	€ 549,341.00	↓ 0.00%	€ 10,000.00	€ 600,000.00	↑ 1.67%	€ 1,500.00	€ 862,578.00	↓ 0.17%
8	Klinë	€ -	€ 895,164.00	↓ 0.00%	€ 10,000.00	€ 800,000.00	↑ 1.25%	€ -	€ 1,373,774.00	↓ 0.00%
9	Fushë Kosovë	€ -	€ 952,782.00	0.00%	€ -	€ 1,500,000.00	0.00%	€ -	€ 3,805,402.00	0.00%
10	Kamenicë	€ -	€ 595,216.00	↓ 0.00%	€ 2,000.00	€ 890,000.00	↑ 0.22%	€ -	€ 956,771.00	↓ 0.00%
11	Mitrovicë e Jugut	€ 35,000.00	€ 1,641,806.00	↓ 2.13%	€ 45,000.00	€ 2,202,320.00	↓ 2.04%	€ 220,000.00	€ 3,673,370.00	↑ 5.99%
12	Leposaviq	€ -	€ 7,403.00	0.00%	€ -	€ 15,000.00	0.00%	€ -	€ 80,000.00	0.00%
13	Lipjan	€ -	€ 935,159.00	0.00%	€ -	€ 1,700,000.00	0.00%	€ -	€ 2,337,990.00	0.00%
14	Novobërdë	€ -	€ 26,421.00	↓ 0.00%	€ 2,016.00	€ 124,000.00	↑ 1.63%	€ -	€ 300,286.00	↓ 0.00%
15	Obiliq	€ -	€ 479,418.00	0.00%	€ -	€ 794,000.00	0.00%	€ -	€ 1,084,437.00	0.00%
16	Rahovec	€ -	€ 913,728.00	↓ 0.00%	€ 5,000.00	€ 950,000.00	↑ 0.53%	€ -	€ 1,445,603.00	↓ 0.00%
17	Pejë	€ 30,000.00	€ 2,391,751.00	↓ 1.25%	€ 60,000.00	€ 2,900,000.00	↑ 2.07%	€ 60,000.00	€ 5,200,497.00	↓ 1.15%
18	Podujevë	€ -	€ 1,280,556.00	0.00%	€ -	€ 1,350,000.00	0.00%	€ -	€ 1,806,493.00	0.00%
19	Prishtinë	€ 40,000.00	€ 19,555,125.00	↓ 0.20%	€ 100,000.00	€ 21,757,920.00	⇒ 0.46%	€ 250,000.00	€ 34,166,863.00	↑ 0.73%
20	Prizren	€ -	€ 4,964,235.00	↓ 0.00%	€ 80,000.00	€ 6,119,080.00	⇒ 1.31%	€ 250,000.00	€ 8,403,558.00	⇒ 2.97%
21	Skenderaj	€ -	€ 162,397.00	↓ 0.00%	€ 17,000.00	€ 750,000.00	↑ 2.27%	€ -	€ 1,318,120.00	↓ 0.00%
22	Shtime	€ -	€ 372,511.00	↓ 0.00%	€ 2,000.00	€ 390,000.00	↑ 0.51%	€ -	€ 587,000.00	↓ 0.00%
23	Shtërpcë	€ -	€ 66,911.00	↓ 0.00%	€ 7,000.00	€ 290,000.00	↑ 2.41%	€ 3,000.00	€ 500,753.00	↓ 0.60%
24	Suharekë	€ -	€ 1,489,433.00	↓ 0.00%	€ -	€ 1,783,000.00	↓ 0.00%	€ 4,000.00	€ 2,193,669.00	↑ 0.18%
25	Ferizaj	€ -	€ 2,731,468.00	↓ 0.00%	€ -	€ 3,926,000.00	↓ 0.00%	€ 7,062.00	€ 6,435,924.00	↑ 0.11%
26	Viti	€ -	€ 661,128.00	↓ 0.00%	€ 34,948.00	€ 870,000.00	↑ 4.02%	€ 26,614.00	€ 1,052,819.00	⇒ 2.53%
27	Vushtrri	€ -	€ 868,719.00	↓ 0.00%	€ -	€ 1,550,000.00	↓ 0.00%	€ 5,000.00	€ 2,900,559.00	↑ 0.17%
28	Zubin Potok	€ -	€ 7,614.00	0.00%	€ -	€ 15,000.00	0.00%	€ -	€ 45,000.00	0.00%
29	Zveçan	€ -	€ 3,991.00	0.00%	€ -	€ 10,000.00	0.00%	€ -	€ 40,000.00	0.00%
30	Malishevë	€ -	€ 808,673.00	↓ 0.00%	€ 2,000.00	€ 750,000.00	↑ 0.27%	€ -	€ 1,158,603.00	↓ 0.00%
31	Junik	€ -	€ 43,172.00	0.00%	€ -	€ 85,000.00	0.00%	€ -	€ 159,330.00	0.00%
32	Mamushë	€ -	€ 78,409.00	0.00%	€ -	€ 60,000.00	0.00%	€ -	€ 70,419.00	0.00%
33	Hani i Elezit	€ -	€ 127,920.00	↓ 0.00%	€ 1,000.00	€ 350,000.00	↑ 0.29%	€ 200.00	€ 560,121.00	↓ 0.04%
34	Graçanicë	€ -		↓ 0.00%	€ 15,000.00	€ 1,150,000.00	↑ 1.30%	€ -	€ 2,181,623.00	↓ 0.00%
35	Ranillug	€ -		0.00%	€ -	€ 80,000.00	0.00%	€ -	€ 108,185.00	0.00%
36	Partesh	€ -		0.00%	€ -	€ 40,000.00	0.00%	€ -	€ 111,214.00	0.00%
37	Klllokot	€ -		0.00%	€ -	€ 75,000.00	0.00%	€ -	€ 153,800.00	0.00%
38	Mitrovica e Veriut	€ -		0.00%	€ -	€ 97,680.00	0.00%	€ -	€ 87,550.00	0.00%
Totali		€ 105,000.00	€ 50,400,000.00	↓ 0.21%	€ 417,734.00	€ 63,394,000.00	↓ 0.66%	€ 851,376.00	€ 98,519,262.00	↓ 0.86%

Konkluzione

- *Raporti për Vendin i Komisionit Evropian për Kosovën, për të disatin vit me radhë nxjerr në pah mungesën e financimit për shërbimet sociale, po ashtu kërkon që në ndryshimet e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal të adresohet krijimi i Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale;*
- *Nga viti 2009 deri tani, Granti i Përgjithshëm ka pasur rritje, por nuk është vërejtur gatishmëri e mjaftueshme e komunave në financim të qëndrueshëm, madje në disa komuna ka rënie të financimit të shërbimeve sociale;*
- *Në vitin 2009 financimi i bartur nga MPMS në komuna për shërbime sociale ka qenë 2.9 milionë euro, që nënkupton financimin e të gjitha QPS-ve në nivel vendi, trendët e financimit të shërbimeve sociale, parë në përqindje, kanë shënuar rënie krahasuar me vitin 2009, ndërkaq mes viteve 2010, 2013, dhe 2023 kanë pasur stagnim sa i përket financimit nga Granti i Përgjithshëm, në vitin 2010, 2.11%; 2013, 2.46 % dhe 2023, 2.22%;*
- *Nga të hyrat vetanke, ka pasur rritje të vogël, edhe kjo kryesisht vërehet në disa komuna, në veçanti komunat ato të mëdha që kanë kapacitete më të larta në mbledhjen e të hyrave vetanake;*
- *Ofrimi i shërbimeve sociale në komuna ballafaqohet me sfida të mungesës së koordinimit, kapaciteteve të ulëta në stafin profesional, mungesë të financimit, si dhe në rrjet të dobët të referimit si qendrat e trajtimit dhe kujdesit ditor;*
- *Raporti vjetor 2019 i Avokatit të Popullit nxjerr në pah se për shkak të mungesës së stafit profesional, mbikëqyrjes, planifikimit të financimit dhe të avancimit të shërbimeve në përputhje me nevojat e komunave, QPS-të janë shndërruar në njësi administrativo-teknike;*
- *Mungesa e kapaciteteve dhe praktikave të financimit të shërbimeve sociale nëpërmes organizatave të specializuara apo ndërmarrësisë sociale, shton barrën dhe rritë hendekun në ofrimin e shërbimeve sociale;*
- *Ndryshimet në formën e financimit përmes ndryshimeve në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, janë të ngadalshme, nga një proces i nisur në vitin 2018;*
- *Në këtë rrjedhë, është ngadalësuar, penguar procesi i ndryshimeve edhe në Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe kostimin e standardeve minimale;*
- *Mungesa e të dhënave të konsoliduara vështirëson planifikimin e shërbimeve dhe financimin.*

Rekomandime

- *Të përshpejtohet procesi i miratimit të ndryshimeve në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, atij për Shërbime Sociale dhe Familjare, duke krijuar Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale dhe kostimin e shërbimeve bazuar në standardet minimale;*
- *Deri në miratimin dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore, komunat bashkë me ministrinë e linjës të adaptojnë kornizat e kritereve, duke rritur financimin përmes Grantit të Përgjithshëm dhe Të Hyrave Vetanake Komunale;*
- *Periodha deri në ndryshimet ligjore, mund të shërbejë në përgatitjen e kapaciteteve komunale në menaxhimin e politikave sociale me kornizën e re të financimit si dhe politikave të reja në këtë fushë;*
- *Në kuadrin e politik-bërjes dhe vendimmarrjes, komunat duhet të shqyrtojnë krijimin e një drejtorie specifike për shërbimet sociale, apo brenda këtyre aktual të ri-organizojnë strukturat dhe kapacitetet në fushën e shërbimeve sociale;*
- *Komunat duhet të forcojnë kapacitetet në financimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale nëpërmjet organizatave të specializuara apo promovimit të ndërmarrësisë sociale;*
- *Ministria e linjës, komunat dhe partnerët/donatorët të vendosin fokusin në fuqizimin e rrjetit/zinxhirit të ofrimit/referimit të shërbimeve sociale nga komunat nëpërmjet menaxhimit ndër-komunal, apo nga ministria përkatëse;*
- *Komunat të përdorin një qasje shumë-dimensionale të përkrahjes në ofrimin e shërbimeve, qoftë nëpërmjet përkrahjes teknike, operacioneve dhe profesionale;*
- *Në procesin e regjistrimit të popullsisë 2023, të sigurohen të dhëna të agreguara dhe të ndara sipas komunave, moshës dhe gjinisë për kategoritë sociale.*



Kosovo Local Government Institute

Address: Str. Enver Gjerqeku no. 20, 10000

Prishtinë, Republic of Kosova

Tel: +383 (0) 38 522 000

Mobile: +383 (0) 44 253 835

E-mail: info@klgi-ks.com | Web: www.klgi-ks.com